



Më
Shabani 25 - 04 - 2018

NË EMËR TË POPULLIT

GT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari individual Adem Shabani, me sekretaren juridike Arditra Imeri, në lëndën penale kundër të akuzuarit [REDACTED], me vendbanim në fshatin [REDACTED], Komuna Ferizaj, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.2312-6/17 të dt.21.11.2017, për veprën penale vjedhje pylli nga nen 358 par.1 të të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkësen e Prokurorisë Themelore në Ferizaj për dhëni e urdhrit ndëshkimore pa mbajtje të shqyrtimit gjyqësor, me dt.18.12.2017 mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.2312-6/17 të dt.21.11.2017, dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari [REDACTED] me vendbanim në fshatin [REDACTED], Komuna Ferizaj, i lindur me dt. [REDACTED] në të njëtin vend, nga i ati [REDACTED], shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së dobët ekonomike, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTORË

Sepse - me dt.03.tetor rrëth orës 14:00, në vendin e quajtur " Livadhet e gjata ", Rajonin Nerodime Jezercë, Komuna Ferizaj, me qëllim vjedhje në pyellin e pronësisë shoqërore, me sharrë motorike ka prerë (22) trungje druri të llojit të ahut, me diameter 18 cm, në lartësi prej boniteti III, si dhe me vëllim të përgjithshëm prej 2,42 metër kub, të cilat i transportuar me qerre me kuaj, duke i shkaktuar kështu dëmë DBZHR Njësisë së Pylltarisë në Ferizaj në vlerë prej 370,26 €uro,-

Me të cilën kreu veprën penale vjedhje pyllit nga nen.358 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të nenit 4,7, 17,41,46,73, të KPRK-së si dhe nenit 495 të KPPK-së.

G J Y K O N

Të akuzuarin [REDACTED] me dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqindë) €, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në rastë se personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mundë të paguaj gjobën, sipas nenit 46, par.3 të KPK-së, i njëjtë dënim do t'i shndërrohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 €uro, do ti llogaritet 1(një) ditë burg.

Obligohet i akuzuari që të dëmtuarës Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari në Komunën e Ferizajit t'ia kompensoj dëmin e shkaktuar në vlerë prej 370,26 €uro,- në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Gjithashtu obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumen prej 20 €, këto në fat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.1712-6/17 të dt.11.09.2017, ka akuzuar të akuzuarin [REDACTED] me vendbanim në fshatin [REDACTED] Komuna Ferizaj, për veprën penale vjedhje pyllit nga nen.358 par.1 të KPRK-së dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhrit ndëshkimor, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallximi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i akuzuari.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovin e kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 par 1.2 dhe 3 të KPPK-së.

Gjykata duke i shikuar provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës gjegjësishtë, fletëparaqitjen e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari në Komunën e Ferizajit nr.63/2017 e dt.23.10.2007 si dhe procesverbalin i Komisionit të ekspertëve i të njejtës datë dhe shkresave të tjera të lëndës., konstatoj se këto prova janë bindëse dhe të bazuara dhe njëkohësisht vërtetojnë se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoj dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata në mbështetje të nenit 463 par.2 të KPPK-së ka obliguar të akuzuarin që të dëmtuarës Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari në Komunën e Ferizajit, t'ia kompensoj dëmin e shkaktuar në shumën prej 370,26 €uro, në afat prej 15 ditesh nga dita e plotëfuqishmerise së ketij aktgjykimi.

Vendimi mbi kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është sjell në bazë të nenit 450 dhe 451 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL
P.nr.2986/2017 dt.18.12.2017

Sekretarja juridike
Ardita Imeri

Gjyqtari
Adem Shabani

UDHËZIM JURIDIK:

Kudër këtij aktgjykimi mundë të ushtrohet kundërshtim në afatin prej 8 (tetë) ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit, gjyqtarit individual të kësaj gjykate përmes kësaj gjykate. Pas kalimit të afatit për kundërshtim, urdhëri ndëshkimor merrë formën e prerë dhe dënimini i shqiptuar ekzekutohet.